

25561

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 25561 VENDIMIT

V E N D I M
PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot me daten 03/03/2001 une gjyqtari i Gjykates se Rrethit Tirane *M. Deda*, pasi studiova kerkesen e Administratorit te SHOQERISE TREGTARE "TOP CHANNEL" SHPK, z.Dritan Hoxha, i cili kerkon qe t'a rregjistrojne kete Shoqeri si person juridik:

K O N S T A T O V A

Se ortaku i vetem z.Dritan HOXHA ka vendosur te themeloje nje Shoqeri Tregtare me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "TOP CHANNEL" SHPK per te ushtuar veprimtari ne fushen e :

- Veprimtarise televizive lokale qe përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit dhe figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablllove, përsërtitësve, satelitëve apo me çdo mjet tjetër.

-SELIA E SHOQERISE do te jete ne Tirane, Qendra Nderkombetare e Kultures.

-KOHEZGJATJA E SHOQERISE: per nje periudhe 20 vjecare.

-KAPITALI I SHOQERISE është 100,000 leke i cili mbulohet nga Ortaku i Vetëm.

-Administrator i Shoqerise do te jete z.Dritan HOXHA.

Dokumentat e paraqitura i plotesojne kushtet per t'a rregjistruar Shoqerine si person juridik.

PER KETO ARESYE

Bazuar ne Ligjin Nr.7638 dt.19.11.92 dhe Ligjit Nr.7667 dt.28.01.1993

V E N D O S A

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregtare "TOP CHANNEL" SHPK me Ortak z.Dritan HOXHA per ushtimin e aktivitetit ne fushen e:

- Veprimtarise televizive lokale qe përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit dhe figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablllove, përsërtitësve, satelitëve apo me çdo mjet tjetër.

-SELIA E SHOQERISE do te jete ne Tirane, Qendra Ndërkombëtare e Kulturës.

-KOHEZGJATJA E SHOQERISE: per nje periudhe 20 vjecare.

-KAPITALI I SHOQERISE eshte 100,000 leke

-Administrator i Shoqerise do te jete z.Dritan HOXHA.

KUNDER KETIJ VENDIMI MUND TE BEHET ANKIM.

U shpall sot me daten .03.2001

Gjyqtari

Morina Deda

KONTRATË
PËR THEMELIMIN E SHOQËRISË TREGTARE
"TOP CHANNEL" SH.P.K.

Sot më datën 21.03.2001, **z.Dritan HOXHA**, biri i Fiqiriut, lindur më 1968, banues në Tiranë, me adresë Rruga "Pandi Dardha", Pall.60, Ap.28, identifikuar me pasaportën Nr.0161795, me vullnetin e tij të lirë dhe në bazë të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993 "Për rregjistrin tregtar", Ligjit Nr.7512 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, veprimtarisë private dhe privatizimit", si dhe në Ligjin Nr. 8410 datë 14.05.1997 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" ka vendosur të krijojë një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sipas kushteve e normave të parashikuara në Statutin e shoqërisë dhe në këtë Akt - Themelimi si më poshtë vijon:

Neni 1

Ortaku i vetëm, **z.Dritan HOXHA**, themelon Shoqërinë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar: **"TOP CHANNEL" Sh.P.K.**

Neni 2

Kjo Shoqëri Tregtare do të ketë selinë e saj në Qendra Ndërkombëtare e Kulturës, Tiranë.

Shoqëria në bazë të legjislacionit shqiptar ka të drejtë të hapi filiale, degë, përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do të hapen.

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë 20 vjet.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë Tregtare "TOP CHANNEL" Sh.p.k do të jetë:

- Veprimtaria televizive lokale që përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit dhe figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablove, përsërtitësve, satelitëve apo me çdo mjet tjetër.

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 000 lekë.

Ky kapital është i ndarë në 100 pjesë ku njëra pjesë është e barabartë me 1 000 lekë. Pjesët e kapitalit themeltar zotërohen 100% nga ortaku i vetëm, z.Dritan HOXHA.

Pjesët e Kapitalit Themeltar përfaqësojnë kontribute në para dhe janë shlyer plotësisht prej ortakut të vetëm.

Neni 6

Kapitali themeltar i Shoqërisë, sipas nenit 4 të kësaj kontrate përfaqëson kapitalin e derdhur nga Ortaku i vetëm i nevojshëm për veprimtarinë e Shoqërisë. Sipas kërkesës së Ligjit Kapitali Themeltar do të depozitohet në një nga Bankat shtetërore ose private që ushtrojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.

Kapitali Themeltar mund të përbëhet edhe nga kontribute në natyrë. Në këtë rast vlerësimi i kontributeve në natyrë do të bëhet sipas N. 42 të Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992.

Në librin e llogarisë që do të krijohet në shoqërinë tregtare do të shënohet edhe kapitali i derdhur nga Ortaku.

Rritja e kapitalit nga ortaku nuk është e kufizuar.

Neni 7

Shoqëria Tregtare në marrëdhëniet me të tretët përgjigjet vetëm me pasuritë e shoqërisë, fondet e saja dhe Ortaku përgjigjet për detyrimet e kësaj Shoqërie vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 8

Shoqëria e pushon aktivitetin e saj me mbarimin e afatit të përcaktuar në këtë kontratë ose për shkaqe të përligjura që gjykohen të tilla nga Ortaku.

Fitimi neto ndahet sipas pjesëve të kontributit në kapitalin themeltar.

Neni 9

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Ortaku i Vetëm.
- Administratori.

Administratori emërohet e shkarkohet prej Ortakut të Vetëm.

Modalitetet për përbërjen dhe funksionimin e organeve të mësipërme përcaktohen nga statuti i Shoqërisë si dhe nga Ligji "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 10

Ortaku është i detyruar të ruajë sekretin e dokumentacionit, informacionit, njohjeve dhe të eksperiencës së këmbyer e të realizuar brenda Shoqërisë dhe të marri të gjitha masat për të evituar përhapjen e tyre qoftë dhe në mënyrë të pjesëshme.

Ortaku është përgjegjës për pasojat e dëmshme, të shkeljeve ndaj ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 11

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 vjeçare.

Shoqëria mund të shpërmdahet edhe para këtij afati në bazë të vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të bëhet konform normave të konventave ndërkombëtare për rregullimin e mosmarrëveshjeve në Shoqëritë Tregtare, në Gjykatën e Rrethit Tiranë ose në një Gjykatë Ndërkombëtare.

Neni 13

Më të detajuara dispozitat për Shoqërinë Tregtare "TOP CHANNEL" Sh.P.K janë përcaktuar dhe përmbahen në Statutin e saj.

Neni 14

Kjo kontratë formulohet në katër kopje, nga të cilat njëra depozitohet në Zyrën e Noterisë Tiranë, njëra depozitohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë, njëra në Zyrën e Tatimeve Tiranë dhe kopja e katërt mbahet në dokumentat e Shoqërisë.

Kontrata është e vlefshme që nga momenti i nënshkrimit të saj nga ortaku i vetëm.

ORTAKU I VETËM

Tiranë më 21/03/2001

Ortaku
Florian

S T A T U T
I
SHOQËRISË TREGTARE
“TOP CHANNEL” SH.P.K.

Shoqëria Tregtare me përgjegjësi të kufizuar “TOP CHANNEL” Sh.P.K, është krijuar sipas kontratës për themelimin e saj nga **Ortaku i Vetëm z. Dritan HOXHA.**

Për të bërë të mundur veprimtarinë ekonomike dhe organizimin e kësaj Shoqërie në përputhje me Ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993 “Për regjistrin tregtar”, si dhe në Ligjin Nr. 8410 datë 14.05.1997 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” është përpiluar ky Statut si më poshtë:

KREU I PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ortaku i vetëm pjesëmarrës në Kontratën e Themelimit ka krijuar një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar.

Shoqëria Tregtare e fiton të drejtën e personit juridik në momentin e regjistrimit të saj në Gjykatën e Rrethit Tiranë si dhe me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar.

Neni 2

- Shoqëria Tregtare emërtohet “TOP CHANNEL” Sh.P.K dhe ka si objekt të saj:
 - Veprimtarinë televizive lokale që përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit dhe figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablllove, përsëritësve, satelitëve apo me çdo mjet tjetër.

Shoqëria në bazë të legjislacionit shqiptar ka të drejtë të hapi filiale, degë, përfaqësi dhe të japë përfaqësimin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do të hapen.

- Selia e shoqërisë tregtare është në Qendra Ndërkombëtare e Kulturës, Tiranë.
- Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë tregtare është parashikuar për një periudhë 20 vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Ky afat mund të zgjatet ose të zvogëlohet sipas vendimit të marrë nga Ortaku i Vetëm.

KREU II

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 3

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare është 100 000 lekë. Ky kapital është i ndarë në 100 pjesë me vlerë 1,000 lekë secila. Pjesët e kapitalit themeltar zotërohen 100% nga ortaku i vetëm, z.Dritan HOXHA.

Pjesët e Kapitalit Themeltar përfaqësojnë kontribute në para dhe janë shlyer plotësisht prej ortakut të vetëm.

Pjesët e Kapitalit Themeltar mund të përfaqësojnë kontribute në para ose në natyrë, por asnjëherë kontribute në shërbime.

Kur pjesët e kapitalit përfaqësojnë kontribute në natyrë vlerësimi i tyre bëhet nga një ekspert për kontributet nëpërmjet një raporti që i bashkangjitet statutit. Eksperti caktohet nga ortaku.

Shoqëria mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e saj.

Neni 4

ZMADHIMI I KAPITALIT

Zmadhimi i kapitalit bëhet me vendim të Ortakut të Vetëm.

Zmadhimi i kapitalit me anë të nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontribute në para, bëhet sipas paragrafit të fundit të nenit 40 të L.Nr.7638/19.11.1992.

Zmadhimi i kapitalit plotësisht ose pjesërisht me anë të kontributeve në natyrë, bëhet sipas kërkesave të nenit 42, paragrafi i parë i L.Nr.7638/19.11.1992. Megjithatë eksperti i autorizuar për kontributet emërohet me vendim të gjykatës sipas kërkesës së administratorit.

Neni 5

ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Ortaku i Vetëm, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Ekspertët i bëjnë të ditur asamblesë vlerësimin e tyre për arësyet dhe kushtet e zvogëlimit.

Neni 6

TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

Pjesët e kapitalit Themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Gjithashtu janë lirisht të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet parardhësve e pasardhësve.

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakut.

KREU I DYTË

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 7

Organi vendimor i Shoqërisë është Ortaku i Vetëm.

Ortaku i vetëm mund ti delegojë kompetencat e tij. Vendimet e tij të marra në vend të asamblese evidentohe në një regjistër.

Ortaku i Vetëm vendos për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive vjetore dhe ndarjes së fitimitbilancin vjetor, ndryshimi i statutit, zvogëlimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së Shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërrimi i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në një shoqëri të formave të tjera etj.

Neni 8

Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore hartohen nga administratori. Ortaku i vetëm miraton llogaritë nëse është e nevojshme pas raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Ortaku ka të drejtë të marrë në çdo moment dokumentat e sipërpërmendura, për 3 vitet e fundit financiarë. Ai mund të ndihmohet nga një ekspert i zgjedhur prej tij, i cili i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit.

Neni 9

Administrator i shoqërisë caktohet Ortaku i Vetëm z.Dritan HOXHA.
Administratori ka të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë në marrëdhënie me të tretët.



Neni 10

Administratori mund të caktohet edhe një person jashtë shoqërisë. Ai emërohet e shkarkohet me miratimin e Ortakut të Vetëm.

Ortaku i Vetëm cakton detyra dhe kompetenca për administratorët.

Neni 11

Kontrolli i Shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar për çdo vit financiar me mundësi rrizgjedhje. Ai caktohet nga mbledhja e Ortaku i Vetëm.

Neni 12

Për punonjësit që do të punësohen në Shoqërinë Tregtare do të zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim duke lidhur kontratat e punës me secilin për një afat jo më shumë se periudha 1 vjeçare.

Paga e punës nuk është e kufizuar por ajo nuk mund të jetë më e ulët se ajo e përcaktuar me vendime të veçanta të qeverisë.

KREU I TRETË

MARRËDHËNIET EKONOMIKO FINANCIARE

Neni 13

Viti financiar fillon më datën 1 Janar dhe mbaron më datën 31 Dhjetor të çdo viti, përveç vitit të parë që fillon me regjistrimin e shoqërisë në Gjykatë.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet e operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël, miratimi i bilanceve dhe i dokumentacionit mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 14

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimit, ortaku i vetëm përcakton pjesën që i takon mbi fitimin, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezervë të domosdoshëm (jo më pak se 1/20 e fitimit të çdo viti, deri sa ky fond të arrijë vlerën e 1/10 të kapitalit themeltar) si dhe të jenë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet e mbartura apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.



Neni 15

Llogaritë ekonomike dhe ato kontabël mbahen në gjuhën shqipe, në lekë ose në valutë të huaj.

Veprimtaria ekonomike mbahet në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim dhe mbështetet në aktivin dhe pasivin që detyrimisht do të pasqyrohen në bilancet e përpiluara nga ekspertët kontabël të autorizuar të cilët mbajnë përgjegjësi ligjore për punën e tyre.

Neni 16

Shoqëria Tregtare me qëllim që ta bëjë sa më të lehtë dhe më të shpejtë pagesat me të tretët do të hapë llogari bankare në një nga Bankat që janë të njohura nga Shteti Shqiptar vendase ose të huaja.

Administratori, z.Dritan HOXHA, ka të drejtë të çeli një llogari bankare në "BANKA e TIRANËS" SH.A në të cilën do të depozitohet kapitali themeltar i shoqërisë në formim.

KAPITULLI I KATËRT

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUJDIMI

Neni 17

Me mbarimin e afatit të përcaktuar në kontratën e themelimit zgjatja e tij bëhet vetëm me vendimin e Ortakut të Vetëm.

Ajo priset kur mbaron afati i përcaktuar dhe Ortaku nuk ka rënë dakort që të bëjë ripërtëritjen e këtij afati.

Shoqëria mund të shndërohet në një nga format e përcaktuara nga ligji dhe në formën e kërkuar nga ligji.

Neni 18

Shoqëria Tregtare hyn në procesin e likujdimi që në momentin e vendosjes për prishjen e saj. Për fillimin e këtij procesi Asambleja e Ortakëve emëron një likujdues i cili paraqet raportin e likujdimi, gjendjen e aktivit e të pasivit të Shoqërisë, mbi mënyrën e ndjekjes së operacionit të likujdimi dhe afatin e nevojshëm për përfundimin e tyre.

Në fund të procesit të likujdimi, Asambleja e Ortakëve, vendos mbi bilancin përfundimtar, mbi aktin dhe rregullsinë e likujdimi, mbi mbylljen e procesit të likujdimi të Shoqërisë.

Neni 19

Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin gjatë ekzekutimit të këtij statuti dhe kontratës së themelimit, gjatë ekzistencës së Shoqërisë si gjatë kryerjes së veprimtarisë ashtu dhe në procesin e likuidimit do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

Neni 20

Ky statut është hartuar në katër kopje, njëra kopje depozitohet në Zyrën e Noterisë, njëra në Gjykatën e Rrethit Tiranë, njëra në zyrën e tatimeve dhe kopja e fundit mbahet në dokumentat e krijimit të Shoqërisë.

ORTAKU I VETËM

Dritan Hoxha



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË**


Nr. *824* Rep.
Nr. *285* Kol.

V Ë R T E T I M

Sot në datën 21.03.2001 (dy mijë e një), në Zyrën e Noterisë në Tiranë para meje Noteres Myrvete PËRMETI u paraqitën Ortaku i Shoqërisë Tregtare "TOP CHANNEL" Shpk z. **Dritan HOXHA**, i biri i Fiqiriut, lindur më 1968, banues në Tiranë, me adresë Rruga "Pandi Dardha", Pall.60, Ap.28, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën Nr.0161795, i cili më deklaroi se këtë kontratë e statut pasi i lexoi me zë të e pasi e gjeti në përputhje me vullnetin e tij e nënshkruan rregullisht me vullnetin e tij të lirë, çka e vërtetoj unë si Notere me nënshkrimin tim.

NOTERE



**NOTERE *
MYRVETE PERMETI**


Disponim

Te verifikohet nese ekziston nje firme me emrin e paraqitur ne kerkese.

Data dhe nenshkrimi i gjyqtarit, gjyqtares

Ne listen e emrave eshte/jane regjistruar me emrin e paraqitur ne kerkese

Nuc ka

nje firme
disa firma
asnje firme

Top Channel shpk

Data dhe nenshkrimi i sekretares se gjykates

28.3.2001 R. Kucini

Get Your Private, Free E-mail from MSN Hotmail at <http://www.hotmail.com>.

STATUT
I SHOQERISE ANONIME "TOP CHANNEL" SH.A.



Sot ne daten 24.03.2006 i nenshkruari Dritan Hoxha, i datelindjes 1968, me shtetesi dhe kombesi shqiptare, banues ne Tirane, me pasaporten 0161495, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne baze te Ligjit Nr.8410 date 30.09.1998 "Per Radion dhe Televizionin Publik e Privat ne Republiken e Shqiperise" se bashku me ndryshimet e bera ne te si dhe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, ka hartuar Statutin e Shoqerise Anonime "TOP CHANNEL" qe vijon te themeluar prej tij.

NENT 1

Forma

Prej personit pronar te aksioneve te krijuara siç tregohet me poshte dhe te atyre qe mund te behen me pas pronare te aksioneve krijohet nje shoqeri anonime pa oferte publike qe rregullohet nga ligjet ne fuqi dhe nga ky statut.

NENT 2

Objekti

Shoqeria ka per objekt :

● Veprimtari ne fushen radiotelevizive, prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te çdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve eletromagnetike, kablllove, perseritesve, sateliteve apo me çdo mjet tjeter.

● Dhe pergjithesisht çdo operacion financiar tregtar, industrial, me pasuri te paluajtshme ose te luajtshme qe mund te lidhen drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e shoqerise.

NENT 3

Emertimi

Emertimi I Shoqerise eshte : " TOP CHANNEL " SH.A.

Ne te gjitha aktet dhe dokumentet qe dalin nga Shoqeria, emertimi i saj do te ndiqet menjehere nga inicialet "SH.A." dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

NENT 4

Vendodhja e selise

Selia e Shoqerise eshte caktuar ne Qendren Nderkombetare te Kultures, Tirane.

Ajo mund te transferohet ne çdo vend tjeter te Rrethit Tirane ose te nje rrethi kufitar me nje vendim te thjeshte te keshillit mbikeqyres, vendim ky qe do te ratifikohet nga asambleja e pergjithshme e zakonshme me e afert.

Selia e shoqerise mund te transferohet kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise ne baze te nje vendimi te asamblese se pergjithshme te jashtezakonshme te aksionereve.

Ne rastin e nje transferimi me vendim te keshillit mbikeqyres ky i fundit eshte i autorizuar te beje ndryshimin e duhur ne statut.

NENI 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte caktuar mbi 20 (njezet) vjet duke filluar nga data e rregjistrimit ne rregjistrin tregtar. Shkurtimi i kesaj kohezgjatje ne rastin e nje prishje te pershpejtuar ose zgjatja e afatit behen me vendim te asamblese se pergjithshme te jashtezakonshme te aksionereve.

NENI 6

Kontributet

Ne momentin e themelimit shoqerise i jane sjelle si kontribut ne para dhe ne natyre nje shume prej 525.400.000 (peseqind e njezet e pesemilion e katerqind mije) leke, qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise. Keto aksione jane nenshkruar teresisht dhe jane shlyer teresisht nga z. DRITAN HOXHA, i cili eshte i vetmi person firmoses i statutit.

Teresia e kontributeve te treguar me siper perben kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 7

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar eshte caktuar ne 525.400.000 (peseqind e njezet e pesemilion e katerqind mije) leke.

Ai eshte i ndare ne 525.400 (peseqind e njezet e pese mije e katerqind) aksione me vlere nominale 1000 (nje mije) leke per secilin dhe te numertuara nga 1 deri ne 525.400.

NENI 8

Llogarite rrjedhese

Aksioneret mund ti japin shoqerise fonde ne llogari rrjedhese. Menyrat e funksionimit te ketyre llogarive vendosen ne cdo rast nga drejtori i shoqerise dhe te interesuarit.

NENI 9

Zmadhimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet sipas modaliteteve dhe menyrave te parashikuara ne nenet 150 deri 163 te ligjit per "Shoqerite Tregtare".



Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te kryhet vetem me vendim te asamblese se jashtezakonshme te aksionereve, ne baze te raportit te drejtorise, i cili permban treguesit e kerkuar nga ligji.

Aksioneret kane te drejten e perpareshise per nenshkrimin e aksioneve te shlyeshme ne para qe emetohen per zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejte eshte perpjestimore me shumen e aksioneve te zoteruara nga secili aksioner perpara zmadhimit te kapitalit.

Aksioneret mund te heqin dore vetem individualisht nga e drejta per nenshkrimin e aksioneve te reja. Ata munden gjithashtu te kerkojne nenshkrimin e nje numri me te vogel aksionesh nga sa u takon sipas parimit te perpjestueshmerise, por me kusht qe asambleja te kete vendosur shprehimisht per kete.

NENI 10

Zvogelimi i kapitalit themeltar

Me rezerven, kur eshte rasti, te te drejtave te kreditoreve, asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mund te autorizojë ose te vendosë zvogelimin e kapitalit per çfaredo arsye ose me çfaredo menyre qofte, por ne asnje rast zvogelimi i kapitalit nuk mund te cenoje barazimin ndermjet aksionereve.

Zvogelimi i kapitalit, per çfaredo shkaku qofte, ne nje shume me te vogel se minimumi ligjor mund te vendoset vetem me kushtin pezullues te nje zmadhimi te kapitalit, i destinuar te çojë kete te fundit te pakten ne minimumin ligjor, perveç rastit kur shoqeria transformohet ne nje shoqeri te nje forme tjeter qe nuk kerkon nje kapital me te larte se sa ai i zvogeluar.

Ne rastin e mosrespektimit te kesaj dispozite çdo i interesuar mund te kerkojë nga gjykata kompetente prishjen e shoqerise.

NENI 11

Shlyerja e aksioneve

Aksionet per kapitalin ne para te nenshkruara ne zbatim te nje vendimi per zmadhimin e kapitalit do te shlyhen te pakten per 25% te vleres se tyre qysh ne momentin e nenshkrimit. Primet e emisionit te aksioneve, kur do te kete te tille, do te shlyhen teresisht ne kohen e nenshkrimit te aksioneve.

Pjesa tjeter e vleres do te shlyhet me nje ose disa keste ne baze te kerkimit per shlyerje nga Drejtoria deri ne nje afat prej 2 vjetesh nga dita kur zmadhimi i kapitalit eshte bere perfundimtar.

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme qe vendos zmadhimin e kapitalit ka te drejte te marre nje vendim per shlyerjen teresore te aksioneve qysh ne momentin e nenshkrimit ose brenda nje afati me te shkurter nga ai i permendur ne paragrafin e dyte te ketij neni.

Kerkimi i fondeve u njoftohet nenshkruesve te pakten 15 dite perpara dates se caktuar per çdo derdhje, me leter rekomande dhe kthim pergjigje, drejtuar cdo titullari te aksioneve.

Çdo vonese ne derdhjen e shumave te kerkuara sjell pagimin e interesave sipas perqindjeve ligjore duke filluar nga data e kerkimit te çdo derdhje pa qene nevoja per te proceduar ne formalitete te tjera te çfaredoshme dhe pa hequr dore nga veprimet e



shoqerise ndaj aksionerit detyruet dhe nga masat e zbatimit te detyruar te parashikuara ne ligj.



NENI 12

Format e aksioneve dhe libri I aksioneve

Aksionet jane te formes emerore .

Pronesia e aksioneve rezulton nga rregjistrimi tyre ne emer te titullarit ose titullareve ne librin e aksioneve te mbajtura nga ana e shoqerise ose nga ndermjetesat financiar.

Secili aksioner ka te drejte te kerkoje me shkrim dhe te marre nje nxjerrje (ekstrakt) nga libri i aksionereve i cili vertetohet me vulen e shoqerise.

Secili aksioner ka te drejte te verifikojte nese emri i tij eshte futur ne librin e aksionereve dhe personi i cili mban librin eshte i detyruar t'i tregojte aksionerit, me kerkesen e ketij te fundit, hyrjen perkatese ne liber.

NENI 13

Shitja dhe transferimi I aksioneve

Aksionet e shoqerise jane te tregtueshme pas regjistrimit te saj ne regjistrin Tregtar. Ne rastin e zmadhimit te kapitalit, aksionet jane lirisht te tregtueshme pas realizimit te ketij zmadhimi. Pas prishjes (likuidimit) te shoqerise aksionet mbeten lirisht te tregtueshme deri ne mbylljen e likuidimit sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Ndryshimi i pronesise se aksioneve si rrjedhoje e nje shitje apo e nje transferimi, kryhen nepermjet nje kalimi nga llogaria e dhenesit tek llogaria e marresit ne baze te nje urdher kalimi ne regjister.

Shoqeria eshte e detyruar te kryej kete regjistrim dhe te kete kalim brenda 6-diteve nga marrja e urdherit.

Urdher kalimi i pergatitur ne nje formular te dhene nga shoqeria ose te miratuar nga shoqeria nenshkruhet nga dhenesi i aksionit ose perfaqesuesi i tij. Nese aksionet nuk jane shlyer teresisht, urdherkalimi nenshkruhet edhe nga marresi.

Shoqeria do te kerkoje qe nenshkrimet e paleve te vertetohen nga nje noter, ose nje person zyrtar i caktuar, pervec rasteve kur ky vertetim eshte perjashtur nga ligji.

Transferimi i aksioneve falas ose si rrjedhoje e trashegimise kryhet gjithashtu, me ane te kalimit ne llogari ne baze te nje dokumenti ligjor qe verteton transferimin.

Shpenzimet per transferimin e aksioneve jane ne ngarkim te marresit, pervec rastit te nje marreveshjeje te kundert midis dhenesit dhe marresit.

Aksionet e pashlyera per derdhjet e kerkuara nuk mund te pranohen per transferim.

Shoqeria harton nje liste te aksionereve ne te cilen tregohet numri i aksioneve te zoteruara, vendbanimi i deklaruar per secilin. Kjo liste hartohet perpara cdo asambleje dhe nje here ne tre muaj.

Sa here qe hartohet lista ne regjistrin e levizjes se aksioneve shenohet data e listes, numri total i aksioneve ekzistues dhe i aksioneve te reja te krijuara, te transferuara, te ndryshuara ose te anuluar qe nga data e hartimit te listes se fundit.

NENI 14

Te drejtat dhe detyrat e lidhura me aksionet


- 
- I. Çdo aksion i jep zoteruesit te tij te drejten e marrjes te nje pjese nga fitimet e shoqerise ne perpjestim me kuoten pjese te kapitalit qe ai perfaqeson.
Çdo aksion jep, gjithashtu te drejten e pjeses ne aktivin e mbetur te shoqerise pas shlyerjes se kreditoreve ne rastin e nje likuidimi te shoqerise.
Pervec ketyre aksioni i jep zoteruesit te tij te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne asamblete e pergjithshme ne kushtet e parashikuara nga ligji ose te caktuara ne kete statut.
- II. Aksioneret jane pergjegjes deri ne kufirin e vleres nominale te aksioneve qe zoterojne. Çdo kerkim fondesh pertej kesaj eshte i ndaluar.
- III. Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet ndjekin aksionin ne çfaredo forme qe ai te transferohet nga njera dore ne tjetren.
Pronesia e nje aksioni permban te drejten e plote te aderimit ne statutin e shoqerise dhe ne vendimet e asamblese.
- IV. Trashgimtarët, kreditorët, personat qe kane te drejta ose perfaqesues te tjere te nje aksioneri, nuk mund te kerkojne dhenien e vulave apo te shenjave te tjera mbi pasurite e shoqerise, ndarjen ose shitjen ne ankand te nje pasurie. Ata nuk mund te perzihen ne aktet e administrimit te shoqerise dhe per ushtrimin e te drejtave te tyre duhet te mbeshteten ne llogarite e shoqerise dhe ne vendimet e asamblese se pergjithshme.
- V. Sa here qe eshte e nevojshme te zoterohen disa aksione per te ushtruar nje te drejte çfardo, ne rast te kembimit, te grupimit ose te dhenies te titujve, ose si rrjedhoje e zmadhimit ose te zvogelimit te kapitalit, te shkrirjes ose te çdo operacioni tjetër te kesaj natyre, zoteruesit e aksionit te vetem ose te nje numri me te vogel nga ai i kerkuar, mund t'i ushtrojne keto te drejta me kusht qe vete ata te hyjne ne nje grupim dhe eventualisht te blerjes ose te shitjes te aksioneve te nevojshem.
- VI. Pervec nje ndalese ligjore, perpara se te procedohet ne cdo ndarje ose ne cdo rimbursim gjate jetes se shoqerise ose ne likuidimin e saj, formohet masa midis te gjithë aksionereve ne menyre te tille qe duke marre parasysh vleren nominale te tyre, te gjitha aksionet e se njejtës kategori te marrin te njejtën shume neto pas heqjes te te gjitha taksave apo tatimeve qe merren persiper nga shoqeria.

NENI 15

Pandashmeria e aksioneve

Aksionet jane te pandashme perkundrejt shoqerise.

Bashkepronaret e aksioneve jane te detyruar te paraqiten prane shoqerise nga njeri prej tyre, i konsideruar si pronar i vetem, ose nje perfaqesues i vetem i zgjedhur nga bashkepronaret. Ne rast mosmarreshje perfaqesuesi mund te caktohet nga gjykata me kerkesen e bashkepronarit qe e merr i pari kete nistem.



NENI 16

Drejtoria, perberja dhe emerimi

Drejtimi i pergjithshem i shoqerise kryhet nga drejtoria, e cila perbehet nga anetare detyrimisht persona fizik. Numri I anetareve te drejtorise caktohet nga Keshilli Mbikqyres

Anetaret e drejtorise emerohen nga Keshilli Mbikqyres. Ata mund te mos jene aksionere te shoqerise, por mund te jene te lidhur me te me nje kontrate punesimi. Asnje anetar i drejtorise nuk mund te beje pjese ne Keshillin Mbikqyres te Shoqerise.

Drejtoria i ushtron funksionet nen kontollin e Keshillit Mbikqyres.

NENI 17

Kohezgjatja e fukcioneve te drejtorise

Drejtoria emerohet per nje periudhe prej 3-vjetesh. Anetaret e saj jane te rizgjedhshem. Kufiri maksimal i moshes per funksionet e anetarit te drejtorise eshte 65 vjec. Megjithate antari i drejtorise qe ka arritur kete kufi te moshes i ruan funksionet e tij deri ne mbledhjen e afert te asamblese se pergjithshme te thirrur per te vendosur mbi llogarite vjetore te ushtrimit financiar te mbyllur.

Neqoftese nje vend i anetarit te drejtorise mbetet bosh Keshilli Mbikqyres duhet ta zevendesoj ate brenda 2-muajsh. Anetari zevendesues emerohet per periudhen qe mbetet deri ne emerimin pasardhes te drejtorise.

NENI 18

Fuksionimi i drejtorise

Drejtoria fuksionon si nje organ kolegjal. Me autorizim te Keshillit Mbikqyres. antaret e drejtorise mund te ndajne midis tyre detyra per drejtimin e shoqerise.

Megjithe ndarjen e detyrave, aktet individuale te çdo anetari te drejtorise konsiderohen te kryera kolegjalisht. Drejtoria duhet te informohet periodikisht per vendimet e anetareve te saj qe kane marre detyra te vecanta.

Keshilli Mbikqyres mund te percaktoj ceshtje per te cilat antaret e drejtorise duhet te marrin vendime bashkarisht.

NENI 19

Perfagesimi tek te tretet

Ne marredheniet me te tretet shoqeria perfaqsohet nga Drejtori I Pergjithshem dhe nga drejtoret e tjere, ne vartesi te numrit qe do te percaktoje Keshilli Mbikqyres.

NENI 20

Mbledhjet e drejtorise dhe vendimet

Drejtoria mblidhet sa here qe e kerkon interesi i shoqerise, me thirrjen nga ana e Drejtorit te pergjithshem ose te njerit nga drejtoret e tjere. Thirrja e mbledhjes behet me cdo menyre.



Mbledhjet e drejtorise behen ne seline e shoqerise. Ato trajtohen nga Drejtori I Pergjithshem dhe ne mungese te tij nga drejtori tjetër qe eshte autor i thirrjes.

Vendimet merren me shumice votash. Vota me prokure eshte e ndaluar. Neqoftese ne mbledhje jane te pranishem vetem 2 antare te drejtorise vendimet duhet te merren me unanimitet.

NENI 21

Kompetencat e drejtorise

Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te shoqerise, por kufizohet nga ato kompetenca qe ligji ua ka dhene shprehimisht Keshillit Mbikqyres dhe Asamblese se Aksionereve.

Drejtoria i ushtron kompetencat e veta brenda objektit te shoqerise.

Ne marredheniet me te tretet shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e drejtorise edhe kur keto akte nuk kane te bejne me objektin e shoqerise pervec kur provon se te tretet e dinin apo nuk mund te mos e dinin se keto akte ishin jashte objektit te shoqerise.

Megjithate me cilesine e masave te rregullit te brendeshem qe nuk u kundevihen te treteve per perfundimin e operacioneve te renditura me poshte drejtoria vepron me autorizim paraprak te Keshillit Mbikqyres.

- a. Dhenia e dorezanive dhe garancive
- b. Kryerja e investimeve tej atyre te parashikuara ne programin financiar vjetor
- c. Hapja e veprimtarise ose degeve te reja, shkrija bashkimi dhe mbyllja teresisht ose pjeserisht e veprimtarive dhe degeve te shoqerise.
- d. Pjesmarrja ne shoqeri te tjera te krijuara ose per te krijuar
- e. Shitja dhe shkembimi i pasurive qe perbejne aktive te qendrueshme te shoqerise
- f. Negocimi, perfundimi a ndryshimi i cdo kontrate me afat ose per nje shume mbi kufijte e percaktuar cdo vit nga keshilli mbikqyres.

Kur nje operacion kerkon autorizimin e Keshillit Mbikqyres dhe ky i fundit e refuzon kete, drejtoria mund te therrase asamblene e pergjithshme dhe i parashtron asaj ceshtjen. Asambleja e pergjithshme vendos per kryerjen ose jo te operacionit.

NENI 22

Shperblimi I anetareve te drejtorise

Menyra dhe shuma e shperblimit te cdo anetari te drejtorise caktohet nga Keshilli Mbikqyres ne aktin e emerimit.

NENI 23

Keshilli Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres perbehet nga 3 anetare. Nga te cilet 2/3 e antareve te Keshillit Mbikqyres emerohen nga mbledhje e jashtzakonshme e asamblese kurse 1/3 zgjidhet nga te punesuarit ne shoqeri.

Anteret e Keshillit Mbikqyres te zgjedhur nga te punesuarit duhet te kene nje kontrate pune me shoqerite te pakten 5-vjet perpara zgjidhjes dhe kontrata ti pergjigjet



nje punesimi efektiv. Ne rast kur numri i ketyre antareve eshte 3, kuadrot dhe specialistet kane 2-vende ne Keshillin Mbikqyres.

NENI 24

Personi Juridik - anetar i Keshillit Mbikqyres

Nje person juridik qe eshte aksioner i shoqerise mund te jete anetar i Keshillit Mbikqyres. Ne kete rast ky duhet te caktoj, qysh ne castin e zgjedhjes, nje perfaqses te perhershëm person fizik, i cili u nenshtrohet te njejtave kushte dhe detyrime dhe ka te njejtat pergjegjisi civile dhe penale sikur te ishte ai vete antar i keshillit, duke mos perjashtuar nga pergjegjsia e perbashket personin juridik qe ai perfaqson.

Neqoftese personi juridik ja heq mandatin perfaqsesit te tij duhet te njoftoj per kete shoqerine pa vonese dhe te beje njekohesisht zevendesimin e tij. Ky rregull do te zbatohet edhe ne rastet e vdekjes, te doreheqjes ose te pengimeve te zgjatura te perfaqsesit te perhershëm.

NENI 25

Kohezgjatja e funksioneve dhe vendet bosh ne Keshillin Mbikqyres.

Kohezgjatja e funksioneve te antareve te Keshillit Mbikqyres eshte 3 vjet, çdo vit shtrihet ne periudhen e kohes midis Asambese se Pergjithshme vjetore te njepasnjeshme.

Askush nuk mund te emerohet per here te pare anetar i Keshillit Mbikqyres n.q.s duke pas arritur moshen 65 vjeç emerimi i tij çon ne me shume se nje te treten e antareve te keshillit qe kane kete moshe.

Ne qofte se nje anetar i Keshillit Mbikqyres mbush moshen 65 vjeç dhe per kete shkak perpjestimi i nje te tretes i percaktuar si me siper tejkalohe, anetari me i moshuar quhet i shkarkuar zyrtarisht ne mbarim te Asamblese se Pergjithshme vjetore me te afert.

Anetari i Keshillit Mbikqyres i emeruar ne zevendesim te tij perfundon mandatin e paraardhesit. Çdo anetar qe perfundon mandatin eshte i riemerueshem perveç rastit kur ka mbushur moshen 65 vjeç.

Ne qoftese nje ose disa vende te antareve te Keshillit Mbikqyres te zgjedhur nga Asambleja mbeten bosh per shkak te vdekjes, doreheqjes ose nje pengimi per nje kohe te gjate, ky keshill mundet, ne periudhen midis dy mbledhjeve te Asamblese, te beje emerime te perkohshme.

Emerimet e perkohshme te bera nga keshilli mbikqyres i nenshtrohen ratifikimit nga Asambleja e pergjithshme ne mbledhjen e saj me te afert. Ne rastin kur asambleja nuk ratifikon emerimet e perkohshme shqyrtimet e bera dhe vendimet e marra nga keshilli mbikqyres mbeten te vlefshme.

Neqoftese numri i antareve te keshillit mbikqyres behet me pak se dy, drejtoria duhet te therrase urgjentisht asamblene e pergjithshme te zakonshem e per te plotesuar efektivin e keshillit.

Anetari i keshillit mbikqyres i emeruar ne zevendesim te nje tjetri qendron ne funksion deri me perfundimin e mandatit te paraardhesit.



NENI 26

Kryetari dhe zevendeskryetari i Keshillit Mbiqyres

Keshilli Mbiqyres zgjedh nga gjiri i tij nje kryetar dhe nje zevendeskryetar qe ngarkohen me mbledhjen e keshillit dhe drejtimin e debatit gjate seancave te tij.

Kryetari dhe zevendeskryetari i Keshillit Mbiqyres jane detyrimisht persona fizike dhe nuk mund te zgjidhen ndermjet perfaqesuesve te personave juridike.

Ata ushtrojne funksionet e tyre gjate periudhes se mandatit ne Keshillin Mbiqyres.

Kryetari dhe zevendeskryetari i Keshillit Mbiqyres jane te rizgjedhshem.

Keshilli Mbiqyres mund te emeroje nje sekretar te zgjedhur midis anetareve te keshillit ose jashte tyre duke caktuar kohezgjatjen e funksioneve te ketij.

NENI 27

Mbledhjet e Keshillit Mbiqyres. Quorumi dhe shumica per marrjen e vendimeve.

Keshilli Mbiqyres mbledhet me thirrjen e kryetarit, ose ne rast pengimi te ketij te zevendeskryetarit, sa here qe e kerkon interesi i shoqerise dhe te pakten nje here ne tre muaj per te degjuar raportin e drejtorise.

Thirrja e keshillit behet me te gjitha menytrat. Kryetari i Keshillit Mbiqyres duhet te therrase mbledhjen e keshillit brenda nje afati prej 15 ditesh kur te pakten nje anetar i drejtorise ose nje e treta e anetareve te keshillit mbiqyres i paraqitin atij nje kerkese te motivuar per kete. N.q.s. kerkeses nuk i jepet udhe autoret e saj mund te procedojne vete ne thirrjen e mbledhjes te Keshillit Mbiqyres duke treguar rendin e dites te mbledhjes.

Mbledhjet e Keshillit Mbiqyres mbahen ne seline e shoqerise .

Rendi i dites vendoset nga kryetari ose ne mungese te tij nga zevendeskryetari , ose nga anetari i drejtorise apo anetaret e Keshillit Mbiqyres qe kane kerkuar thirrjen e mbledhjes.

Shqyrtimet dhe vendimet e keshillit mbiqyres jane te vlefshme kur numri i anetareve te pranishem ne mbledhje eshte te pakten sa gjysma e anetareve ne funksion.

Vendimet merren me shumicen e votave te anetareve te pranishem dhe te perfaqesuar. Ne rast votash te barabarta ajo e kryetarit eshte percaktuese.

Ne seline e shoqerise mbahet nje rregjister i pranise i cili firmoset nga anetaret e keshillit pjesemarres ne séance.

Shqyrtimet dhe vendimet e Keshillit Mbiqyres evidencohen me procesverbale te hartuara ne nje rregjister te posacem, i numertuar dhe i vulosur, qe mbahet ne selite e shoqerise, ne te cilin tregohen anetaret e pranishem, te perfaqesuar dhe qe mungojne, si edhe çdo person qe ka asistuar ne mbledhje, teresisht apo pjeserisht.

Procesverbalet firmosen nga drejtuesi i mbledhjes dhe nga nje anetar i keshillit

NENI 28

Kompetencat e Keshillit Mbiqyres

Keshilli Mbiqyres ushtron kontrollin e perhershëm te drejtimit dhe administrimit te shoqerise nga ana e drejtorise.



Ai vendos per operacionet qe duhet te kryhen me autorizim te tij ne baze te nenit 21 te ketij statuti.

Keshilli Mbikeqyres miraton strukturen organizative te shoqerise dhe ndryshimet e saj, kriteret e punesimit dhe te pagave si dhe rregulloren e brendshme te shoqerise.

Ne çdo kohe te vitit Keshilli Mbikeqyres kryhen te gjitha verifikimet dhe kontrollet qe ai çmon te arsyeshme dhe ka te drejte te kerkoje te njihet me dokumentat qe ai gjykon te nevojshme per permbushjen e funksioneve te tij. Njehere ne tre muaj ai merr me raport te paraqitur nga drejtoria.

Brenda tre muajve nga mbyllja e cdo viti financiar drejtoria i paraqet atij me qellim verifikimi dhe kontrolli, llogarite vjetore, si dhe nje raport te shkruar per gjendjen e shoqerise dhe aktivitetet e saj gjate vitit financiar te mbyllur

NENI 29

Informimi i anetareve te keshillit.

Çdo anetar i Keshillit Mbikeqyres ka te drejte te kerkoje dhe te marre nga Drejtoria informacion per ceshtje te natyres administrative, teknike dhe financiare qe i mundesojne atij te verifikojte dhe te gjykoje per kushtet ne te cilat zhvillohet veprimtaria e shoqerise dhe te jete plotesisht i qarte per vendimet qe duhen marre apo qe do te merren nga ana e keshillit.

Kryetari i keshillit ka pergjegjesine per ti vene anetaret e keshillit ne gjendje qe te marrin informacionet e kerkuara.

Çdo anetar i keshillit duhet te njoftohet personalisht per mbledhjet e keshillit dhe ti vihen ne dispozicion ne seline e shoqerise apo ti dergohen bashke me thirrjen dokumentet dhe raportet qe do te shqyrtohen ne mbledhje.

Shoqeria nuk eshte e detyruar ti jape anetareve te keshillit te drejtuesve kopje te procesverbaleve te vendimeve te keshillit, per cdo anetar mund te kerkoje qe te njihet me to ne seline e shoqerise.

Mosnjohja e te drejtave te cdo anetari te keshillit per informacionet e mesiperme dhe mosthirrja ne mbledhjen e keshillit sjell pavlefshmerine e vendimeve te keshillit.

NENI 30

Shperblimi i vecante per pjesemarrjen ne keshill dhe shperblimet e jashtezakonshme

Asambleja e pergjithshme e zakonshme mund t'u caktojte anetareve te keshillit mbikeqyres si shperblim per pjesemarrjen ne keshill nje shume vjetore fikse, e cila mbetet e pandryshuar deri ne nje vendim te kundert te asamblese.

Keshilli Mbikeqyres mund te caktojte shperblime te jashtezakonshme per anetaret te cileve u ngarkohen misionet apo u jepen mandate per sherbime apo detyra te caktuara. Shperblimet e jashtezakonshme i nenshtrohen miratimit nga asambleja e pergjithshme e zakonshme sipas rregullave te parashikuara nga nenet 122 deri 126 te ligjit "Per shoqerite tregtare".

Shperblimet e vecanta dhe te jashtezakonshme perballohen nga llogaria e shoqerise dhe kalohen ne shpenzimet e saj.

Perveç shperblimeve te permendura ne kete nen, anetareve te keshillit nuk u caktohet asnje shperblim tjeter i perhershëm ose jo.



NENI 31

Marreveshjet qe kerkojne autorizim

Çdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe nje nga anetaret e drejtorise ose te Keshillit Mbiqeqyres, qe lidhet drejteperdrejte, apo me te cilen nje nga personat e siperpermendur lidhet indirekt apo nepermjet nje personi ndermjetes duhet te autorizohet paraprakisht nga Keshilli Mbiqeqyres.

Kryetari i Keshillit Mbiqeqyres njofton ekspertin kontabel te autorizuar per marreveshjet autorizuara nje muaj perpara se marreveshja te lidhet dhe I shtron keto marreveshje per miratim Asamblese se Pergjithshme .

Ekspertet kontabel te autorizuar i paraqitin Asamblese nje raport te posacem per keto marreveshje, e cila vendos mbi kete raport.

Dispozitat e mesiperme nuk zbatohen per marreveshjet qe kane te bejne me operacionet rrjedhese dhe te kryera ne kushte normale.

NENI 32

Marreveshjet e ndaluara

Anetareve te drejtorise dhe te Keshillit Mbiqeqyres, pervec kur keta te fundit jane persona juridike, u ndalohet te kontraktojne qe tq marrin hua nga shoqeria, t'u akordohet nga shoqeria nje zbulim ne llogari rrjedhese ose ne nje forme tjeter, si dhe te bejne shoqerine dorezenese apo garante per detyrimet e tyre ndaj te treteve.

I njejti ndalim zbatohet per perfaqesuesit e perhershem te personave juridike anetare te Keshillit Mbiqeqyres. Ky ndalim zbatohet gjithashtu, per bashkeshortin, paraardhesit dhe pasardhesit personave te permendur ne kete nen si dhe per çdo person ndermjetes.

NENI 33

Detyrimi per ruajtjen e sekretit

Anetaret e drejtorise dhe te Keshillit Mbiqeqyres si dhe çdo person tjeter qe asiston ne mbledhjet e ketyre organeve duhet te ruajne fshehtesine per çeshtjet dhe te dhenat qe kane karakter te brendshem.


NENI 34

Natyra e asamblese dhe karakteri detyrues i vendimeve

Asamblete e pergjithshme te aksionereve cilesohen asamble te zakonshme ose te jashtezakonshme sipas natyres se vendimeve qe ato jane thirrur per te marre.

Çdo asamble e pergjithshme e mbledhur rregullisht perfaqeson teresine e aksionereve me te drejte vote.

Vendimet e asamblese se pergjithshme detyrojne te gjithë aksioneret madje edhe ata qe mungojne ne mbledhje apo qe votojne kunder.



NENI 35

Thirrja dhe vendi i asamblese

Asamblete e pergjithshme thirren nga Keshilli Mbikeqyres ose nga drejtorja. Ato mund te thirren gjithashtu, nga Eksperti kontabel i autorizuar i pavarur ne rast urgjence, nga nje mandatmbajtes i caktuar nga gjykata dhe kur eshte rasti nga likujduesi.

Asamblete e pergjithshme mblidhen ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te treguar me thirrje.

Thirrja e asamblese se aksionereve behet me ane te njoftimit qe i dergohet çdo aksioneri ne adresen e tij me leter rekomande.

Njoftimi duhet te bjere ne doren e aksionereve apo te njihet prej tyre 15 dite perpara mbledhjes se asamblese dhe duhet te permbaje ditën , oren dhe vendin e mbledhjes, natyren e asamblese, dhe rendin e dites .

Kur asambleja e mbledhur nuk ka mundur te marre vendim per shkak se nuk eshte siguruar quorumi i kerkuar mbledhja e dyte thirret jo me vone se nje muaj nga data e thirrjes se pare ne te njejtat forma si e para. Njoftimi ose letrat e thirrjes se mbledhjes se dyte rikujtojne datën dhe rendin e dites.

NENI 36

Rendi i dites

Rendi i dites se mbledhjes se asamblese percaktohet nga autori i thirrjes .Nje ose disa aksionere qe perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit themeltar te shoqerise kane te drejte te kerkojne qe te futen ne rendin e dites nje apo disa projektrezoluta.

Keto projektrezoluta dergohen ne seline e shoqerise te shoqeruara me nje kerkese ne te cilen tregohen edhe arsyet, si dhe me nje dokument qe provon zoterimin e pjeses se kapitalit themeltar te kerkuar nga paragrafi i dyte i ketij neni.

Projektrezoluta dhe dokumentet shoqeruese duhet te mberrijne ne seline e shoqerise te pakten 5 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese.

Asambleja e aksionereve nuk mund te marre ne shqyrtim nje çeshtje qe nuk eshte perfshire ne rendin e dites. Megjithate ajo mundet, ne çdo rrethane, te shkarkoje nje ose disa anetare te Keshillit Mbikeqyres dhe te beje zevendesimin e tyre.

NENI 37

Hyrja ne asamble

Çdo aksioner, pavaresisht nga numri i aksioneve qe zoteron, ka te drejte te asistojë ne mbledhjet e asamblese se pergjithshme dhe te marre pjese ne vendimet e saj, personalisht apo nepermjet nje perfaqesuesi. Hyrja ne mbledhjet e asamblese te pergjithshmebehet ne baze te nje dokumenti qe provon identitetin.

Çdo aksioner mund te perfaqesohet ne mbledhjet e asamblese vetem nga bashkeshorti ose nga nje aksioner tjeter. Per kete qellim perfaqesuesi duhet te pajiset nga aksioneri me mandat te posaçem, ne kushtet e parashikuara nga ligji.



NENI 38

Evidenca e pjesemarrjes ,drejtimi I mbledhjes dhe proces verbalet

Per çdo mbledhje te asamblese mbahet nje flete-pranie e cila permban treguesit qe provojne identitetin e aksionerit dhe aksionet e zoteruara prej tij. Flete-prania firmoset ne ane nga aksioneri ose, kur eshte rasi nga perfaqesuesi i tij dhe vertetohet per saktesine e saj nga komisioni vezhgues i mbledhjes.

Mbledhjet e asamblese drejtohen nga kryetari i Keshillit Mbikeqyres dhe ne mungese te tij, nga zevendes kryetari apo nje anetar i keshillit i caktuar posaçerisht per kete qellim. Ne rastet kur thirrja e mbledhjes eshte bere nga Eksperti Kontabel i Autorizuar, mandatmbajtesi i caktuar nga gjykata apo likujduesi, mbledhja drejtohet nga autori i thirrjes.

Funksionet e vezhgimit te mbledhjes kryhen nga dy aksionere te pranishem te cilet vehte ose si perfaqesues, zoterojne nje numer votash me te madh se aksioneret e tjere. Vezhguesit caktojne nje sekretar i cili mund te mos jete aksioner.

Komisioni i vezhgimit, i formuar ne kete menyre, ka per detyre te verifikojë, vertetoje dhe nenshkruaje flete-pranine, te mbikeqyre zhvillimin e debateve, te kontrolloje votimet e kryera dhe te siguroje rregullaritetin e tyresi dhe te mbikeqyre mbajtjen e procesverbalit te mbledhjes.

Per cdo mbledhje te asamblese hartohet nje procesverbal, i cili permban:

- daten dhe vendin e mbledhjes
- menyren e thirrjes
- rendin e dites
- drejtuesi i mbledhjes dhe komisioni i vezhgimit
- numri i aksioneve qe marrin pjese ne votim
- quorumi i arritur
- permendjen e dokumenteve dhe te raporteve qe jane shtruar ne mbledhje
- nje permbledhje te debateve
- tekstet e projektrezolutave te vena ne votim, ato te miratuara dhe ato te hedhura poshte
- nga aksioneret
- rezolutat e votimeve

Procesverbalet e mbledhjes te asamblese hartohen ne nje regjister te posaçem, i numertuar dhe i vulosur, i cili ruhet ne seline e shoqerise.

NENI 39

Quorumi, votimi, numri i votave

Ne asamblete e pergjithshme, te zakonshme dhe te jashtezakonshme, quorumi llogaritet per teresine e aksioneve qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise.

E drejta e votes qe u perket aksioneve eshte perpjestimore me kapitalin qe ato perfaqesojne.

Çdo aksion i kapitalit i jep zoteruesit te pakten te drejten e nje vote. Megjithate kur aksionet e shoqerise zoterohen nga nje ose disa persona juridike ne te cilet shoqeria ka, drejtperdrejt ose terthorazi, kontrollin e drejta e votes te aksioneve te personave



juridike nuk mund te jete me shume se 10% te votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

Votimi kryhet me doren ngritur, me thirrje emerore ose i fshehte sipas vendimit te komisionit te vezhgimit dhe drejtuesit te mbledhjes se asamblese.

Votimi kryhet i veçante per çdo çështje apo vendim.

NEENI 40

Asamblete e pergjithshme te zakonshme

Asambleja e pergjithshme e zakonshme mbledhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve te vitit pasardhes, per te vendosur mbi llogarite e shoqerise per ushtrimin financiar te mbyllur.

Ajo ka, midis te tjerash, kompetencat qe vijojne:

- ❖ te miratoje strategjine e zhvillimit afatgjate te shoqerise.
- ❖ te miratoje plan-biznesin dhe planin financiar vjetor.
- ❖ te miratoje, ndryshoje ose te hedhe poshte llogarite vjetore qe i jane shtruar per miratim.
- ❖ te vendose per shperndarjen dhe destinimin e rezultatit ne pajtim me dispozitat ligjore dhe me statutin.
- ❖ te emeroje dhe shkarkoje anetaret e Keshillit Mbikeqyres.
- ❖ te shkarkoje me propozim te Keshillit Mbikeqyres, anetaret e drejtorise.
- ❖ te emeroje ekspertin ose ekspertet kontabel te autorizuar.
- ❖ te miratoje ose te mosmiratoje emerimet e anetareve te Keshillit Mbikeqyres te kryera nga vete keshilli si emerime te perkohshme.
- ❖ te caktoj shperblimin e veçante dhe shperblime te tjera te parashikuara ne kete statut per Keshillin Mbikeqyres.
- ❖ te vendose per raportin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar lidhur me marreveshjet qe i nenshtrohen autorizimit paraprak te Keshillit Mbikeqyres.

Asambleja e zakonshme merr çdo vendim qe nuk sjell ndryshime te statudit.

Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne jo me pak se 50 per qind te aksioneve me te drejte vote. Ne rast se mbledhja e pare nuk realizohet, per mbledhjen e dyte nuk kerkohet asnje lloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem apo te perfaqesuar.

NEENI 41

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme.

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mbledhet sa here qe duhet te merret nje vendim qe sjell ndryshime te ketij statuti.

Ajo nuk mund te shtojte detyrimet e aksionereve pervec operacioneve qe rrjedhin nga rigrupimi i aksioneve i kryer rregullisht.

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne te

pakten $\frac{3}{4}$ e aksioneve me te drejte vote. Per mbledhjen e dyte ky quorum eshte jo me pak se $\frac{1}{2}$ e aksioneve me te drejte vote.

Vendimet e asamblese se jashtezakonshme merren me shumicen prej $\frac{3}{4}$ te votave qe u perkasin aksionereve te pranishem.

NENI 42

Venia ne dispozicion te aksionereve te dokumentave dhe informacioneve

Shoqeria mban dhe ve ne dispozicion te aksionereve, ne kushtet dhe ne afatet e parashikuara nga ligji, raportet, dokumentet dhe llogarite vjetore qe shqyrton asambleja.

Me perjashtim te inventareve dhe te ndonje dokumenti tjeter te caktuar nga asambleja, dokumentet qe duhet t'u vihen ne dispozicion aksionereve u dergohen ketyre bashke me njoftim-thirrje per mbledhje.

NENI 43

Eksperti kontabel i autorizuar. Emerimi dhe shperblimi

Asambleja e pergjithshme e aksionereve, cakton nje ekspert kontabel te autorizuar, te zgjedhur nga lista e Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar.

Ne caktimin e eksperteve kontabel te autorizuar mbahen parasysh perjashtimet dhe papajtueshmerite e percaktuara nga ligji "Per shoqerite tregtare".

Ekspertet kontabel te autorizuar caktohen per nje kohe qe i pergjigjet nje ushtrimi financiar. Ata jane te ricaktueshem. Shperblimi i ekspertit caktohet nga asambleja e aksionereve dhe perballohet nga shoqeria.

NENI 44

Detyrat dhe te drejtat

Detyrat dhe te drejtat e eksperteve kontabel te shoqerise jane ato te parashikuara nga ligji "Per shoqerite tregtare".

Asambleja e aksionereve mund t'u kerkoje eksperteve kontabel te autorizuar kryerjen e kontroleve apo verifikimeve te posaçme per çeshtje ne interes te shoqerise. Ekspertet kontabel te autorizuar thirren ne mbledhjen e drejtorise qe mbyll llogarite e vitit financiar te mbyllur si dhe ne te gjitha asamblete e aksionereve. Raportet qe ata pergatitin depozitohen ne seline e shoqerise, ne afatet e parashikuara nga ligji .

NENI 45

Ushtrimi financiar


Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin periudhen nga data e rregjistrimit ne rregjistrin tregtar deri me 31 Dhjetor.

NENI 46

Inventari. Llogarite vjetore.

Shoqeria mban nje kontabilitet te rregullt ne pajtim me ligjin.



Ne mbyllje te cdo ushtrimi financiar Drejtoria harton inventarin e elementeve te ndryshem te aktivitet dhe te pasivitet ne kete date, si dhe llogarite vjetore te shoqerise.

Drejtoria harton raportin vjetor per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar te mbyllur, ndryshimet e ardhshme te parashikueshme, ngjarjet e ndodhura midis dates kur eshte hartuar raporti, dhe veprimet e kerkimit te zhvillimit.

NEENI 47

Rezultati , caktimi dhe shperndarja

Rezultati i veprimtarise percaktohet nga diferenca midis te ardhurave dhe te shpenzimeve, pas zbritjes te amortizimeve dhe te provizioneve. Nga fitimet e ushtrimit pasi te jene zbritur, kur eshte rasti, humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5% per te krijuar fondet e rezerves se domosdoshme. Kur kjo rezerve arrin 1/10e kapitalit themeltar nuk behen me heqje nga fitimet e ushtrimit.

Fitimi i shperndashem formohet nga fitimi i ushtrimit duke hequr humbjet e meparshme dhe shumat e hequra per rezervat dhe duke shtuar fitimet e pashperndara te trasheguara.

Megjithkete, pas heqjes se shumave per t'u kaluar ne rezerve ne zbatim te ligjit, asambleja e pergjithshme, mund te heqe cdo shume qe ajo e gjykon te pershtatshme per te krijuar rezerva te zakonshme ose te jashtezakonshme ose per ta mbartur shumen ne ushtrimin e ardhshem.

Fitimi i shperndashem qe mbetet shperndahet ndermjet aksionereve perpjestimisht me numrin e aksioneve qe i perkasin secilit.

Asambleja e pergjithshme mund te vendose venien ne shperndarje te shumave qe ajo heq nga rezervat qe ka ne dispozicion. Megjithate dividendet caktohen ne rradhe te pare nga fitimet e shperndashme te ushtrimit.

Perjashtuar rastin kur vendoset zvogelimi i kapitalit, aksionereve nuk mund t'u behet asnje shperndarje n.q.s.si rrjedhoje e shperndarjes kapitalet e veta te shoqerise jane ose do te beheshin me te vogla se shuma e kapitalit te kerkuar nga ligji plus rezervat qe nuk mund te shperndahen.

N.q.s. eventualisht ndonje ushtrim financiar mbyllet me humbje, shuma e humbjes pas miratimit te llogarive vjetore nga asambleja, mbartet ne ushtrimin vijues, per t'u mbuluar nga fitimet e ushtrimeve te ardhshme deri ne shuarjen e saj .

NEENI 48


Menyrat e pagimit te dividendeve. Paradheniet

Asambleja e pergjithshme ka te drejte t'i jape cdo aksioneri per te gjithë ose per nje pjese te dividendeve nje opsion midis pagimit ne para dhe pagimit me aksione.

Kerkesa per pagimin e dividendeve me aksione duhet te behet ne afatin e caktuar nga asambleja i cili nuk mund te jete me shume se tre muaj nga data e vendimit te asamblese.

Menyrat e pagimit te dividendeve ne para caktohen nga asambleja e pergjithshme, ose ne mungese te saj nga drejtoria. Pagimi i dividendeve ne para duhet te kryhet brenda 9 muajve pas mbylljes se ushtrimit financiar, pervec ky afat zgjatet me vendim te gjykates.

Drejtoria mund te vendose pagimin e dividendeve perpara mbylljes te ushtrimit ne forme paradhenie por me respektimin e kerkesave te parashikuara nga ligji.



NENI 49

Kapitalet e veta me pak se gjysma e kapitalit themeltar

Neqoftese per shkak te humbjeve te pesuara, te konstatuara ne dokumentet kontabel kapitalet e veta te shoqerise behen me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar drejtoria eshte e detyruar qe brenda 4-muajeve nga miratimi i llogarive vjetore ku jane evidentuar keto humbje te therrase asamblene e pergjithshme te jashtezakonshme te aksionereve me qellim qe te vendose nese ka vend per prishjen e pershpejtuar te shoqerise.

N q s asambleja nuk shpall prishjen e shoqerise, atehere ne afatin e parashikuar nga ligji dhe ne rezerven e nenit 10 te ketij stauti kapitali duhet te zvogelohet ne nje shume te barabarte me ate te humbjes se konstatuar nqs ne kete afat kapitalet e veta nuk jane ribere te pakten te barabarte me gjysmen e kapitalit themeltar.

Ne te dy rastet vendimi i asamblese se pergjithshme publikohet sipas rregullave te kerkuara nga ligji.

NENI 50

Prishja. Likuidimi

Perjashtuar rastin e nje prishje me vendim gjyqi te parashikuar nga ligji shoqeria mund te priset me mbarim te afatit te caktuar me statut ose me vendim te asamblese se pergjithshme te jashtezakonshme te aksionereve.

Pervec rastiit te bashkimit ose te ndarjes prishja e shoqerise per cfardo shkak qofte sjell likujdimin e saj. Likujdimi kryhet nga nje ose disa likujdatore te emeruar nga asambleja e pergjithshme e zakonshme ose nga asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme ne kushtet e quorumit dhe te shumices per asamblete e zakonshme.

Likuidatori perfageson shoqerine. Ai ka kopetenca te plota per te shitur aktivitet e shoqerise, per te shlyer kreditorët dhe per te shperndare mbetjen e disponueshme.

Asambleja pergjithshme e aksionereve mund te autorizojë likuidatorin te vazhdojë çështjet ne proces ose te ndermarre çështje te reja per nevojat e likujdimit.

Aktivi neto i mbetur, pas shlyerjes te vlerse nominale te aksioneve ndahet midis aksionerve ne perpjestim me pjesmarrjen e tyre ne kapital.

NENI 51

Kundershtimet

Te gjitha kundershtimet gjate funksionimit te shoqerise ose gjate likujdimit te saj qe lindin midis shoqerise dhe aksionereve ose midis vete aksionereve, lidhur me veprimtarine e shoqerise, i nenshtrohen juridiksionit te gjykatave kopetente ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 52

Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres

Emerohen si antare te Keshillit te pare Mbikqyres per nje kohe prej 3-vjetesh:



1. Besnik Myftari, i biri i Azisit i dtl 14/04/1968, banues ne Rr.Ylbere Bylykbashi, Pall. 25, Tirane.
2. Filip Çakuli, i biri i Kostas, i dtl 17/10/1955, banues ne Rr.Reshit Çollaku, Tirane.
3. Alban Jaho, i biri i Nuriut, i dtl 31/05/1969, banues ne Rr.Kavajes, Pall. 166, Tirane.

te cilet kane bere te ditur qe pranojne funksionet respektive dhe pohojne se nuk jane te prekur nga asnje papajtueshmeri apo ndalim qe pengon emerimin e tyre .

NENI 53

Ekspertet Kontabel te Autorizuar

Emerohet si ekspert kontabel i autorizuar per nje kohe prej nje viti financiar Znj. Irena Pulo, e cila ka bere te ditur qe pranon funksionet e saj dhe pohon se nuk eshte e prekur nga asnje papajtueshmeri apo ndalim qe pengon emerimin e saj.

NENI 54

Rimarrja persiper e detyrimeve

Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e rregjistrimit ne rregjistrin tregtar. Megjithate perpara kesaj date per llogari te shoqerise ne krijim e siper jane kryer aktet te ndryshme duke pasur secili akt detyrime qe rrjedhin per shoqerine.

Aksioneri firmoses i ketij statuti e njeh kete gjendje. Rregjistrimi ne rregjistrin tregtar sjell marrjen persiper zyrtarisht nga ana e shoqerise te ketyre detyrimeve, sikur ato te ishin kontraktuar qe ne fillim prej saj.

Pervec ketyre dhe qe tani, aksioneret e thirrur (ne te ardhmen) per te bere drejtimin e pergjithshem te shoqerise autorizohen te kryejne aktet qe hyjne ne objektin e shoqerise dhe ne kompetencat e tyre. Pas rregjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregtar keto akte do t'i nenshtrohen miratimit te asamblese se pergjithshme te zakonshme te aksionereve e thirrur per te vendosur per llogarite vjetore te ushtrimit te pare.

Ky miratim do te sjelle marrjen persiper zyrtarisht nga shoqeria te akteve dhe te detyrimeve te cilat do te quhen si te nenshkruara qe ne fillim nga shoqeria.

NENI 55

Publikimet

Me qellim qe te kryhen publikimet lidhur me statutin e shoqerise, te gjitha kompetencat i jepen z.DRITAN HOXHA, i cili:

- firmos dhe ben te publikohet njoftimin i themelimit ne nje gazete te autorizuar per njoftimet ligjore.
- kryen te gjitha formalitetet per rregjistrimin e shoqerise ne rregjistrin tregtar
- dhe pergjithsisht per te kryer te gjitha formalitetet e kerkuara nga ligji.



NENI 56
Shpenzimet


Te gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara per kete akt dhe aktet qe rrjedhin prej tij i perkasin nenshkruarit deri sa shoqeria te rregjistrohet ne regjistrin tregtar.

Nga data e ketij rregjistrimi keto shpenzime do te merren teresisht ne ngarkim nga shoqeria e cila do t'i amortizojë ato perpara çdo shperndarje te fitimit dhe e shumta brenda nje afati prej 5 vjetesh.

Ne 4(kater) ekzemplare sa kerkon ligji.

AKSIONERI I VETEM

DRITAN HOXHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Noter.Artan Treska.Rr."B.Curri".
Nr 612 Rep. Nr 318 Kol

V Ë R T E T I M

Sot më datë 29/03/2006, në Zyrën e Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht para meje noterit Artan Treska, z. **DRITAN HOXHA** i datelindjes 1968, me shtetesi dhe kombesi shqiptare, banues ne Tirane, me pasaporten 0161495, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili më deklaroi se sa me siper eshte **Statuti i Shoqerise Anonime "TOP CHANNEL"** i konceptuar dhe nenshkruar me vullnetin e tij te lire e te plote dhe unë noteri duke e gjetur konform ligjit e vërtetoj atë.

NOTER

NOTER
ARTAN TRESKA
RR.BAJRAM CURRI
TEL.0682140355.

